



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

**LEGJISLATURA V**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 59

Prishtinë, më 21.3.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Salih Salihu, Adem Salihaj, Shaip Muja, Murat Hoxha, Time Kadrijaj, Emilija Rexhepi.

Munguan: Haxhi Shala, Sergjan Popoviç.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.3.2017;
3. Shqyrtimi i rekomandimeve për çështjen e Hades;
4. Formimi i grupit punues për Projektligjin për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës;
5. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen, sipas rendit të përcaktuar të ditës.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës, për këtë mbledhje, u miratua pa ndonjë shtesë.

### 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.3.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 14.3.2017, u miratua pa vërejtje.

### 3. Shqyrtimi i rekomandimeve për çështjen e Hades

**Kryetarja, Duda Balje**, hapi diskutimin rreth çështjes së Hades, fillimisht duke ia dhënë fjalën z. **Adem Salihaj**, i cili elaboroi për propozim-rekomandimet si vijon:

1. **Qeveria, në afat prej tre muajsh, të nxjerrë aktet e nevojshme dhe ta bëjë një plan për zhvendosjen e fshatit Hade, pjesa e mbetur.**
2. **Zhvendosja e fshatit Hade, pjesa e mbetur, mund të kryhet në faza, por duhet të përfundohet më së largu deri më 31 janar të vitit 2019. Brenda këtij afati duhet të kryhet e gjithë procedura e vlerësimit, zhvendosjes dhe kompensimit të pronave dhe aspekteve të tjera, të përfshira në rekomandimin në pikën 5.**
3. **Qeveria mund t'u ofrojë banorëve të Hades, pjesa e mbetur, troje në Shkabaj, në këmbim të trojeve të tyre, por pa i detyruar ata që ta pranojnë këtë.**
4. **Duke marrë parasysh se Qeveria, me vendimet e saj, ka shkelur të drejtat e njeriut të banorëve të Hades, pjesa e mbetur, duke pamundësuar ndërtimin e shtëpive të banimit dhe objekteve të tjera, duke penguar zhvillimin normal ekonomik, si dhe zhvillimin normal të familjes, duke i ekspozuar në zhurmë, pluhur, tym dhe gazra, atëherë obligohet që ta marrë parasysh edhe këtë aspekt të kompensimit të dëmit që ua ka shkaktuar.**
5. **Në vendbanimin e ri në Shkabaj, deri më 31 dhjetor 2019, të përfundohet në tërësi infrastruktura, duke përfshirë rrugët, ujësjellësin, kanalizimin, rrjetin elektrik dhe shkollën.**
6. **Qeveria, në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit, fillimisht, në një afat prej tre muajsh, më vonë çdo gjashtë muaj, ta informojë me shkrim Kuvendin për hapat e ndërmarrë lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve.**

Ai potencoi pikën 4, si më të ndjeshme, ngase janë shkelur të drejtat e njeriut dhe është ndalur zhvillimi i gjithmbarshëm, ndaj Qeveria duhet të angazhohet seriozisht në këtë drejtim, deri në vitin 2019, kurse komisioni të jetë mjaft aktiv, në mënyrë që mos të krijohet përshtypja që po zhvillohet në komision, ndonjë fushatë apo zvarritje pa nevojë. Propozoi që në këtë debat komisioni të gjejë solucionet apo plotësimet e duhura p.sh. të kërkohet rezolutë apo debat parlamentar, duke propozuar rekomandimet e komisionit etj., ndërsa hartimi i ligjit në grupin punues të pezullohet tre muaj, derisa të përfundojnë përpjekjet e komisionit që të gjejë rrugëdalje. **Shaip Muja** ishte dakord për rekomandime për mbledhjen plenare, mirëpo pasi që Kuvendi do të ketë interpelancë për mihjen sipërfaqësore, ishte i mendimit që kjo ofertë për zhvendosje, t'i dërgohet Kryesisë për të bashkëngjitur interpelancës, ngase neni 9 i Ligjit për Obiliqin, vështirë është i

zbatueshëm, nëse nuk kalon Ligji për minierat e mineralet, ku pastaj nga tantiema 50% do t'i ndahej çështjes së Hades, përndryshe nuk vlen të angazhohemi për ndonjë debat humanitar, por për një debat me bazë ligjore. **Duda Balje**, pyeti propozuesin e rekomandimeve, **Adem Salihaj**, lidhur me tejkalimin e çështjeve të ndjeshme financiare, i cili tha se Qeveria do të ketë mjaft afat, deri në vitin 2019, duke pasur parasysh edhe këtë vit, të planifikojë realizimin e tantiemës, që do të ndahej në tri pjesë, kurse propozimin e Shaip Mujës, nuk e përkrahu, për të bashkëngjitur këtë kërkesë ndonjë interpelance tjetër, ngase duhet pikë e veçantë në plenare. **Time Kadrijaj**, gjithashtu, ishte e mendimit për pikë të veçantë në plenare, ndërsa rreth çështjeve që diskutoi z. Muja, ajo sugjeroi lobim edhe nga tjerët për suksesin e tantiemës së Obilikut, pasi që ndikon në Hade 50%. Gjithashtu, edhe **z. Salihaj** përkrahu angazhimin e z. Muja, por pasi të kemi propozime konkrete nga komisioni përkatës dhe jo vetëm lobime, që ndoshta do të shkonin huq. **Emilija Rexhepi** nuk u pajtua për bashkëngjitje interpelancës, ngase kjo është çështje e ndjeshme dhe nuk u pajtua që komisioni të rekomandojë, por të propozoi debat parlamentar dhe aty të vendoset. **Murat Hoxha** ishte në dilemë, ngase kemi terme që duhet të saktësohen. E para, shpronësimi nuk vlen për këtë rast, ngase nuk ka elementet e eksproprijimit, e dyta, zhvendosjen nuk e njeh ligji, dhe e treta, duhet të ndodhë eksproprijimi, nëse nuk realizohet saktësimi i emërtimeve, kot do të mundohet Qeveria. **Valbona Puka**, nga Institucioni i Avokatit të Popullit, njoftoi komisionin se në kuadër të hartimit të ligjit për shpronësime, në grupin punues, po bëhen disa aktivitete qeveritare rreth zhvendosjes së Hades, me kornizë, siç tha ajo, me një kompani të jashtme, por jo kornizë me bazë ligjore, andaj edhe situata është shqetësuese. **Emilija Rexhepi** dhe **Adem Salihaj**, konstatuan se ky njoftim nuk është ndonjë risi, ngase ministri, qysh para një viti, këto gjëra i ka potencuar, dhe mu për këtë arsye, ky komision duhet që me vendosmëri të insistojë në realizimin e debatit parlamentar, por me rekomandime, të cilat do të jenë obligim për Qeverinë, por nuk pajtohem, vazhdoi, të thuhet se çdo fshat nga një ligj, ngase Hade është një rast i veçantë që kërkon trajtim të veçantë. Qeveria, vazhdoi **Emilija Rexhepi**, po frigohem se pastaj mundet të demantojë aktivitetet që duhet të ndërmerren dhe kështu do të kemi politizim të çështjes. **Salih Salihu** ishte i mendimit se kjo Qeveri nuk mërzhitet për këta njerëz, dhe duke parë që në këtë mbledhje nuk do të mund të tubohen të gjitha variantet e propozuara, sugjeroi që në mbledhjen e radhës të rishikohen rekomandimet e propozuara, kurse **Adem Salihaj** u pajtua, ngase do të përmirësohen edhe disa gabime teknike tjera. **Shaip Muja** nuk kundërshtoi debatin parlamentar, me rekomandime, por ç' vlen ai debat, siç tha ai, nëse nuk ka bazë ligjore. **Komisioni do të rishikojë, në mbledhjen e radhës, edhe një herë rekomandimet dhe do t'i dërgohen mbledhjes plenare.**

#### **4. Formimi i grupit punues për Projektligjin për Krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës.**

Ky projektligj ka kaluar në lexim të parë.

**Kryetarja** konstatoi formimin e grupit punues: **Murat Hoxha**, kryesues, **Emilija Rexhepi**, **Time Kadrijaj** dhe **Salih Salihu**, si dhe pritet që së shpejti të caktohet takimi i grupit punues.

## **5. Të ndryshme**

Mbledhja e radhës mbahet të hënën, më 27 mars 2017. Me këtë njoftim, kryetarja përmbylli mbledhjen e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12.10.

**E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit.**

Kryetarja e Komisionit,

-----  
**Duda Balje**